**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**BASHKIA DIBËR**
**DREJTORIA E RINISË, SPORTEVE DHE HIGJENËS**

**PROJEKT - VENDIM**
**Nr. 01, Date 20/02/2024**
**Për miratimin e Projektit:**

*"Marrëveshje për planin e veprimit për fazën e dytë të iniciativës "Bashki Mike e Fëmijëve" 2024-2026".*

Në mbështetje të ligjit nr 139 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" (I ndryshuar) , neni 9, pika 1.6, shkronja "a" dhe nenin 64, shkronja "a" dhe"gj". Bazuar në marrëveshjen mes Bashkisë Dibër dhe UNICEF më datë 22.12.2022 me nr prot. 5876 dhe vendimin e Këshillit Bashkiak nr 122 datë 22.12.2022.

**Kërkojmë:**

1. Miratimin e iniciativës "Bashki Mike e Fëmijëve" 2024-2026.
2. Në zbatim të këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e rinisë, sporteve dhe higjenës.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak dhe shprehjes për bazueshmërinë ligjore nga ana e institucinit të prefektit të Qarkut Dibër.

**Për Bashkinë Dibër:**

Drejtoria e rinisë, sporteve dhe higjenës
Znj. Denisa BASHA

Drejtoria Juridike
z. Ismeti ŞARAÇI

KRYETARI I BASHKISË
**Rahim SPAHIU**
Në mungesë dhe me autorizm
Zv. Kryetari i Bashkisë
**Z. Ruzhdi DEDA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR

unicef
for every child

UNICEF-i NË SHQIPËRI

Nr. 5876 Prot

Dibër, më 22.12.2022

Nr. / Prot

Dibër, më 22.12.2022

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**

**NDËRMJET**

**BASHKISË SË DIBRËS**

**DHE UNICEF**

Kjo **Marrëveshje Bashkëpunimi** (referuar në vijim si "**Marrëveshja**") zyrtarizon partneritetin dhe angazhimin e Bashkisë së Dibrës dhe Fondit të Kombeve të Bashkuara për Fëmijët ("UNICEF"), për të përcaktuar mënyrat e bashkëpunimit në kuadër të Iniciativës "Bashki mike e fëmijëve" në Shqipëri.

Midis:

Bashkisë së Dibrës, me adresë Bulevardi "Elez Isufi", Peshkopi, Shqipëri, përfaqësuar nga Z. Rahim Spahiu, Kryetar i Bashkisë, referuar në vijim si "Bashkia e Dibrës"

dhe

**UNICEF**, një organizatë ndër qeveritare, themeluar përmes Rezolutës 57 (I), miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 11 dhjetor 1946, si një organ përfaqësues i Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, me zyrë në Rruga "Skënderbej", Ndërtesa e OKB-së, Kati i 3-të, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga Dr. Roberto De Bernardi, referuar në vijim si **"UNICEF"**.

Bashkia e Dibrës dhe UNICEF-i, referuar në vijim si **"Palë"** më vete dhe **"Palët"** bashkërisht,

***Duke marrë parasysh se:***

A. Bashkia e Dibrës është njësi e qeverisjes vendore, ngritur në përputhje me Kushtetutën e Shqipërisë, e cila ndërmerr, midis të tjerash, nisma për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve, të rinjve dhe familjeve që janë pjesë e juridiksionit të saj.

B. UNICEF, në përputhje me Kartën dhe Deklaratat e Misionit, punon me qeverinë, shoqërinë civile dhe organizata të tjera në mbarë botën për përparimin e të drejtave të fëmijëve udhëhequr nga Konventa e të Drejtave të Njeriut.

C. Bashkia e Dibrës dhe UNICEF shprehin dëshirën për të bashkëpunuar në kuadër të Iniciativës "Bashki mike e fëmijëve" sipas termave dhe kushteve të parashikuara me anë të kësaj Marrëveshjeje.

***Palët bien dakord si më poshtë vijon:***

## NENI 1

## Qëllimi i Marrëveshjes

Marrëveshja synon vendosjen e bashkëpunimit institucional ndërmjet palëve me qëllim krijimin e mekanizmave për funksionimin e Iniciativës "Bashki mike e fëmijëve" në Dibër.

Përmes kësaj Marrëveshje, Palët shprehin angazhimin dhe përcaktojnë detyrimet e përbashkëta për ndërmarrjen e hapave dhe veprimtarive të nevojshme për arritjen e këtij qëllimi.

## NENI 2

## Baza ligjore

Kjo Marrëveshje bazohet në:

i. nenin 9, pika 1.6, shkronja "a" dhe nenin 64, shkronjat "a" dhe "gj", të ligjit nr. 139/2015 për "Vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar);

ii. Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar);

iii. Marrëveshjen Bazë të Bashkëpunimit të nënshkruar nga Qeveria Shqiptare dhe UNICEF më 23 korrik 1993;

iv. Ligjin nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"

v. Ligjin nr.18/2017 "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e fëmijës", Neni 46, pika a, b, c, ç, d.

vi. Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021-2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA DIBËR

vii. Programin e Bashkëpunimit për Zhvillimin e Qëndrueshëm, nënshkruar nga Qeveria Shqiptare dhe Organizata e Kombeve të Bashkuara më 25 tetor 2021, për periudhën 2022-2026;

viii. Dokumentin e Programit të UNICEF për Shqipërinë, miratuar nga Bordi Ekzekutiv i UNICEF-it në shtator 2021, për periudhën 2022-2026; dhe

ix. Planin e Punës së UNICEF-it 2022-2023.

**NENI 3**

**Objekti dhe Fusha e Veprimtarisë**

3.1 Objekti i Marrëveshjes është përcaktimi i komponentëve të ndërveprimit të Palëve, në kuadër të zbatimit të iniciativës "Bashki mike e fëmijëve". Kjo iniciativë synon të fuqizoje bashkitë, komunitetet ose njësitë administrative e qeverisjes vendore, në të cilat zërat, nevojat, prioritetet dhe të drejtat e fëmijëve janë pjesë përbërëse e politikave, programeve dhe vendimeve publike. Vizioni është që çdo fëmijë dhe i ri të shijojë fëmijërinë e tij/saj dhe të arrijë potencialin e plotë të zhvillimit.

3.2 Bashkia e Dibrës dhe UNICEF mund ta rinovojnë/ rishikojnë Marrëveshjen, në varësi të progresit të shënuar dhe sfidave të reja që mund të lindin gjatë bashkëpunimit midis Palëve.

3.3 Fusha e veprimtarisë së Marrëveshjes do të përfshijë të gjitha veprimtaritë dhe nismat e tjera që kanë lidhje me zbatimin e objektit të kësaj Marrëveshje.

**NENI 4**

**Detyrimet e Palëve**

4.1 Sipas Nenit 1, **Bashkia e** Dibrës do të:

i. Delegojë funksionet koordinuese të nismës "Bashki mike e fëmijëve" tek një personel në Bashki, i cili do të ketë përshkim pune të rishikuar për të përfshirë përgjegjësitë e reja. Ky personel nuk duhet të jetë nga sektori i mbrojtes së fëmijëve.

ii. Drejtojë dhe koordinojë me aktorë të ndryshëm (qeveritar dhe joqeveritar) ngritjen e strukturave mbikëqyrëse për nismën (komiteti drejtues i iniciativës).

iii. Krijojë forumin konsultativ të fëmijëve, si organ këshillimor pranë këshillit bashkiak. Përfaqësimi i fëmijëve në forum do të jetë nga të gjitha shkollat e bashkisë, në nivel qeverie nxënësish. Për këtë arsye një memorandum mirëkuptimi do të lidhet me

Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Dibër. Në partneritet edhe me organizatat e shoqërisë civile, do të organizohen 2 dëgjesa në këshill bashkiak me fëmijët në lidhje me buxhetimin për nevojat e tyre.

iv. Koordinojë përpjekjet për mbledhjen e statistikave të fëmijëve; të kryejë dhe shpërndajë analizën e situatës së të drejtave të fëmijëve për Bashkinë Dibër, (me angazhimin e fëmijëve, prindërve dhe aktorëve të tjerë kryesorë vendorë).

v. Koordinojë hartimin e Planit të Veprimit (3 vjeçar), duke siguruar angazhimin e të gjithë aktorëve dhe të mundësojë mbulimin e sa më shumë aktiviteteve me buxhetin e nevojshëm. Ky proces do të mundësojë krijimin e një regjistri të nevojave për bashkëfinancime apo projekte në fushën e zhvillimit/realizimit të objektivave.

vi. Dorëzojë planin e veprimit dhe raportin vjetor të progresit në Këshillin Bashkiak për miratim.

vii. Koordinojë përpjekjet për monitorimin dhe raportimin vjetor të Planit të Veprimit, për të identifikuar arritjet, nevojat dhe sfidat e mundshme gjatë zbatimit.

viii. Promovojë iniciativën përmes platformave të ndryshme.

4.2 Sipas Nenit 1, **UNICEF-i,** në varësi të burimeve financiare dhe njerëzorë në dispozicion do të:

i. Ofrojë mbështetje teknike për kryerjen e analizës së situatës së të drejtave të fëmijëve në Bashkinë Dibër.

ii. Ofrojë mbështetje teknike për hartimin e Planit të Veprimit (3 vjeçar), përcaktimin e prioriteteve, aktiviteteve dhe kornizës së rezultateve.

iii. Ofrojë mbështetje teknike për përcaktimin e roleve dhe përgjegjësive të komitetit drejtues të nismës "Bashki mike e fëmijëve" dhe trajnimin e anëtarëve të komisionit, përfshirë përfaqësues të shoqërisë civile.

iv. Ofrojë mbështetje teknike për ngritjen e forumit konsultativ të fëmijëve dhe trajnimin e tyre për të kontribuar në hartimin e Planit të Veprimit dhe monitorimin e tij. Si pjesë e trajnimeve do të jetë dhe fuqizimi i fëmijeve për ta përçuar zërin e tyre në degjesat me këshillin bashkiak gjatë buxhetimit.

v. Ofrojë mbështetje teknike në monitorimin dhe raportimin vjetor të zbatimit të Planit të Veprimit.

vi. Promovojë iniciativën përmes platformave të ndryshme.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA DIBËR

vii. Promovojë platformën U-Report, si një mundësi për fëmijët dhe adoleshëntët për të dhënë mendimin e tyre mbi çështjet që i shqëtësojnë ata në komunitetet ku jetojnë.

4.3 Përveç listës së veprimeve të mësipërme, secila palë mund të kërkojë të shtojë përgjegjësi shtesë si pjesë e këtij bashkëpunimi. Në këtë rast, veprimet shtesë do të konfirmohen me shkrim ndërmjet palëve.

**NENI 5**

**Kohëzgjatja e Marrëveshjes dhe Hyrja në Fuqi**

5.1 Kjo Marrëveshje është e vlefshme deri më 30 Dhjetor 2025, përveç nëse zgjidhet përpara kësaj date nga Palët.

5.2 Kjo Marrëveshje hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Palët.

**NENI 6**

**Pronësia Intelektuale**

6.1 Në përputhje me rregullat, rregulloret, politikat dhe procedurat e UNICEF-it, të gjitha të drejtat e pronësisë intelektuale dhe të drejtat e tjera pronësore, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar te materialet e shtypura ose të shkruara, materialet me pamje dhe zë, apo materiale të tjera, që përgatiten, mblidhen ose prodhohen si rezultat i ose gjatë zbatimit të Projektit, i përkasin UNICEF-it. Asnjë element në këtë Marrëveshje nuk jep asnjë të drejtë për pronësinë intelektuale mbi këto materiale. Gjatë kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshje, UNICEF mund t'i japë leje me shkrim Bashkisë së Dibrës për t'i përdorur këto materiale, të cilat i nënshtrohen kushteve të përdorimit, siç përcaktohen nga UNICEF.

6.2 Secila prej Palëve merr përsipër ta përdorë logon dhe emblemën e Palës tjetër, sipas rastit, në lidhje vetëm me këtë Marrëveshje, përveçse kur merret leje paraprake për raste të veçanta nga njëra prej Palëve dhe Pala tjetër njoftohet me shkrim.

6.3 Të gjitha informacionet dhe materialet, duke përfshirë edhe informacionin e transmetuar dhe digjital që Bashkia e Dibrës synon t'ia ofrojë publikut apo palëve të treta, të cilat janë Pronë e UNICEF-it apo i referohen Marrëveshjes ("Materiale Promovuese") duhen rishikuar dhe miratuar me shkrim nga UNICEF-i përpara se të përdoren. Materialet që paraqiten për miratim duhet të jenë në përputhje me Paketën e Mjeteve të Brandit të UNICEF-it. Bashkia e Dibrës nuk mund ta ndryshojë pamjen ose paraqitjen e Pronave të UNICEF-it. Miratimi i UNICEF-it duhet të jepet brenda pesë (5) ditësh pune. Nëse nuk merret miratimi me shkrim i UNICEF-it, materiali konsiderohet i pamiratuar. Bashkia e

Dibrës mbulon të gjitha kostot e prodhimit dhe shpërndarjes së Materialeve Promovuese, përveç kostove të veta për asistencën në përgatitje, që mbulohen nga vetë UNICEF-i.

**NENI 7**

**Të ndryshme**

7.1 Kjo Marrëveshje përfshin të gjitha komunikimet e tjera midis Palëve lidhur me objektin e tij, qoftë me shkrim ose jo.

7.2 Çështjet që nuk janë parashikuar në këtë Marrëveshje adresohen në përputhje me Planet e Veprimit ose korrespondencën e shkëmbyer midis Palëve.

7.3 Çdo ndryshim i kësaj Marrëveshje bëhet me shkrim dhe me marrëveshje midis Palëve.

7.4 Palët mund ta zgjidhin këtë Marrëveshje përmes njoftimit me shkrim vetëm nëse rrethanat cënojnë zbatimin me sukses të Planit të Veprimit, të përgatitur për këtë qëllim.

7.5 Palët zbatojnë të gjitha veprimtaritë dhe/ose ekspertizën e programuar apo të kërkuar në kuadrin e kësaj Marrëveshje, që janë në proces e sipër në momentin e zgjidhjes së kësaj Marrëveshje.

7.6 Të gjitha njoftimet, apo komunikimet në kuadrin e kësaj Marrëveshje, bëhen me shkrim dhe i dërgohen Palëve në adresat e mëposhtme:

**UNICEF në Shqipëri**
Personi i Kontaktit: Specialistja e Monitorimit të të Drejtave të Fëmijëve dhe Vlerësimit
Zj. Elda Denaj, e-mail: edenaj@unicef.org

**Bashkia e Dibrës**
Drejtori i kabinetit të kryetarit
Denisa Basha, e-mail basha.deni@hotmail.com

7.7 Asnjë element i kësaj Marrëveshje ose lidhur me të nuk konsiderohet si heqje dorë, qoftë shprehimisht, apo në mënyrë të nënkuptuar, nga asnjë prej privilegjeve apo imuniteteve të Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe organeve të saj përfaqësuese, duke përfshirë edhe UNICEF-in, qoftë në kuadër të Konventës së OKB-së të Privilegjeve dhe Imuniteteve, apo të instrumenteve të tjera, dhe asnjë dispozitë e kësaj MM-je nuk interpretohet apo zbatohet në mospërputhje me këto privilegje dhe imunitete.

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA DIBËR**

unicef
for every child

**UNICEF-i NË SHQIPËRI**

Kjo Marrëveshje hartohet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje të barasvlershme në gjuhën angleze dhe shqipe, 2 (dy) kopje për secilën palë. Në rast mospërputhjesh midis dy versioneve, mbizotëron ai në gjuhën angleze.

Për sa më sipër, Palët ekzekutojnë këtë Marrëveshje Mirëkuptimi.

**Z. Rahim Spahiu**

**Kryetar**

**Bashkia Dibër**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA DIBËR

**Dr. Roberto De Bernardi**

**Përfaqësues**

**Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët**

UNITED NATIONS CHILDREN'S FUND * UNICEF TIRANA *

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA DIBËR

# Bashkia Mike e Fëmijëve

## 2024 -2026

Diber, Nentor 2023

## PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA ........................................ 2

ÇFARË ËSHTË INICIATIVA BASHKI MIKE E FËMIJËVE ........................................ 3

OBJEKTIVAT DHE AKTIVITETET ........................................ 7

SEKSIONI 1 - PLANI I VEPRIMIT ........................................ 16

SEKSIONI 2 – KOMITETI DREJTUES ........................................ 27

SEKSIONI 3 – FORUMI KONSULTATIV I FËMIJËVE/ADOLESHENTËVE (FKF) ........................................ 29

SEKSIONI 4 – RAPORTIMI VJETOR I INICIATIVËS: FORMAT I THJESHTUAR ........................................ 31

SEKSIONI 5 – LISTA E PIKAVE FOKALE TË ZBATIMIT TË PLANIT ........................................ 32

SEKSIONI 6 – KOSTIMI I PLANIT DHE BUXHETI ........................................ 34

SEKSIONI 7– INSTRUMENTAT PER MATJEN E PERCEPTIMEVE ........................................ 35

SEKSIONI 8 – MEMORANDUMI I MIREKUPTIMIT ........................................ 47

# ÇFARË ËSHTË INICIATIVA BASHKI MIKE E FËMIJËVE

Bashkia "Mike e Fëmijëve (Adoleshentëve)" është një iniciative, ku bashkia zbatuese angazhohet për të përmirësuar jetën e fëmijëve brenda juridiksionit të tyre duke realizuar të drejtat e tyre siç janë artikuluar në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës (KDF) dhe me specifikisht në nenet kryesore që janë: interesi më i mirë i fëmijës; mosdiskriminimi; zbatimi i të drejtave, pjesëmarrja dhe zotërimi i proceseve; jeta dhe mbijetesa; si dhe respektimi i zërit të tyre.

Në praktikë, kjo iniciativë është një bashki, komunitet ose njësi administrative apo çdo njësi e qeverisjes vendore, në të cilën zërat, nevojat, prioritetet dhe të drejtat e fëmijëve janë pjesë përbërëse e politikave, programeve dhe vendimeve publike vendore. Vizioni është që çdo fëmijë dhe adoleshent të shijojë fëmijërinë e tij dhe të arrijë potencialin e plotë brenda komunitetit të tyre.

Fushat kryesore të ndërhyrjes janë:

- Qeverisje e mirë lokale me fokus fëmijët e bazuar në:
    - Sisteme të përmirësuara për politk-bërje, buxhetim dhe monitorim.
    - Planifikime bazuar në evidencë dhe monitorim të vendimeve në nivel vendor.
    - Angazhime efikase të përfituesve dhe aktorëve të tjerë për të rritur sinegjinë.
- Mjedise të sigurta, të pastra dhe të mbrojtura:
    - Lëvizja e sigurtë dhe e pavarur e fëmijëve në komunitet ku jetojnë.
    - Mjedise të pastra dhe të gjelbërta.
- Loja dhe koha e lirë:
    - Hapësira të aksesueshme për lojë dhe kohën e lirë
    - Standarde dhe mekanizma të sigurisë
- Mjedis mundësues
    - Gjithpërfshirja dhe pjesëmarrja
    - Inovacioni dhe teknologjia

## Objektiva e iniciativës

Nisma do të ndihmojë Bashkinë Dibër të prioritizojë dhe masë punën për përfshirjen dhe avancimin e të drejtave të fëmijës në planet e saj vendore, monitorimin dhe përditësimin e tyre bazuar në evidenca, si dhe angazhimin efikas të përfituesve dhe palëve të interesuara për të rritur sinergjinë e veprimeve.

## Strategjitë kryesore

- Krijimi i sinergjive mes strukturave vendimarrëse që kanë në qendër fëemije, adoleshentë, dhe të rinj.
- Planifikimi dhe buxhetimi strategjik me fokus fëmijët, adoleshentët dhe të rinjtë.
- Monitorimi i vazhdueshëm dhe mbledhja e të dhënave që tregojnë situatën e fëmijëve në Bashkinë Dibër.

- Marrja e masave aktive për të reduktuar/eliminuar diskriminimin, dhunën ne familje dhe trafikimin e qenieve njerëzore.
- Komunikimi i vazhdueshëm, ndërgjegjësimi dhe advokimi për të drejtat e fëmijëve.

## Roli i bashkisë Dibër

Bashkita Dibër në bashkëpunim me UNICEF Shqipëri, do të:

- Koordinojë dhe nënshkruajë Memorandum Mirëkuptimi (MM) për zbatimin e iniciativës.
- Koordinojë zhvillimin e analizës së situatës së të drejtave të fëmijëve në konsultim me fëmijët, adoleshentët, të rinjtë dhe aktorët kryesorë në bashkinë Dibër.
- Koordinojë hartimin e Planit të Veprimit dhe angazhimin e palëve të interesuara në sigurimin e buxhetit të nevojshëm për të garantuar zbatimin e tij.
- Finalizojë Planin e Veprimit dhe arrijë miratimin e tij në Forumin Bashkiak;
- Përcaktojë rolet/personat koordinues që do të përfaqësojnë iniciativën (njësia koordinuese lokale).
- Monitorojë progresin dhe gjenerimin e dëshmive për të identifikuar dhe adresuar mundësitë dhe sfidat e mundshme gjatë zbatimit.

## Roli i UNICEF Shqipëri

UNICEF Shqipëri do të mbikëqyrë dhe koordinojë nismën në nivel kombëtar. Roli i tij do të përfshijë:

- Përcaktimin e prioriteteve të përgjithshme kombëtare për nismën dhe objektivat kombëtare sipas qasjes metodologjike të miratuar.
- Finalizimin e modelit të iniciativës që do të përdoret më tej për vlerësimin dhe njohjen e bashkive miqësore për fëmijët dhe adoleshentët.
- Përcaktimin e kornizës dhe procesin e monitorimit dhe vlerësimit për bashkitë dhe komunitetet pjesëmarrëse.
- Njohjen e bashkive miqësore për fëmijët dhe adoleshentët.

## Cikli i zbatimit

**Memorandumi i Mirëkuptimit**

Zhvillohet dhe lidhet memorandumi i mirëkuptimit me bashkinë kandidate për zbatimin e iniciativës.

**Analiza e Situatës**

Zhvillohet analiza e situatës së të drejtave të fëmijëve dhe adoleshentëve në Bashkinë kandidate duke ekzaminuar statistikat, politikat lokale, ligjet dhe hulumtimet ekzistuese të lidhura me situatën dhe mirëqenien e fëmijëve dhe adoleshentëve. Kjo analizë lehtëson të kuptuarit e kontekstit, plotësimin e roleve dhe proceseve vendimmarrëse të qeverisjes vendore dhe aktorëve të tjerë në nivel vendor dhe nxjerr në pah fushat më të rëndësishme të shqetësimit për fëmijët dhe adoleshentët, shkaqet kryesore dhe atë që fëmijët dhe adoleshentët duan të ndryshojnë. Analiza do të informojë zhvillimin e Planit Lokal të Veprimit, do të vendosë bazat mbi të cilat do të monitorohet dhe vlerësohet progresi dhe impakti, do të ofrojë dëshmi për politikëbërjen dhe do të identifikojë nevojat për zhvillimin e kapaciteteve lokale. Analiza e situatës mbështet qeveritë vendore në identifikimin e sfidave lokale të të drejtave të fëmijëve, çfarë pasojash kanë për fëmijët dhe adoleshentët dhe ndryshimet dhe rezultatet e parashikuara.

**Ngritja e mekanizmave vendore**

(i) Krijohet Komiteti drejtues i iniciativës, i cili ofron udhëzime dhe drejtime të përgjithshme mbi zbatimin e saj, dhe më konkretisht miraton planin e vprimit dhe buxhetin vendor të iniciativës; identifikon personin koordinues për rolin e sekretariatit dhe monitorin progresin dhe identifikon dhe adreson mundësitë dhe sfidat e mundshme.

(ii) Krijohet forumi konsultativ i fëmijëve (Fëmijët dhe Adoleshentët) i cili ofron një mekanizëm formal për të nxitur dhe zbatuar pjesëmarrjen e fëmijëve në vendimmarrjen e qeverisjes vendore. Si përfaqësues (zëri) i fëmijëve, Forumi mund të përdoret si një iniciativë miqësore me fëmijët dhe adoleshentët, duke hartuar politikat pjesëmarrëse dhe përfshirjen e qytetarëve të fëmijëve dhe të rinjve në komunitetet ku ata jetojnë.

**Finalizimi/Aprovimi i Planit**

Zhvillohet korniza e veprimit, prioritizimi i qëllimeve dhe zhvillimi i Planit të Veprimit (2 deri në 5 vjet) bazuar në gjetjet e analizës së situatës. Hapat kyç janë formulimi i një teorie ndryshimi, zhvillimi i një kuadri logjik me tregues për të monitoruar progresin dhe ndikimin, dhe identifikimi i roleve, përgjegjësive dhe afateve, si dhe burimeve (ndarja e buxhetit) për aktivitetet në Planin e Veprimit. Planet e Veprimit do të përqendrohen në fushat e synimeve kryesore të përcaktuara dhe janë ato më urgjente, përmes masave që janë në kompetencë dhe mandat të autoriteteve të bashkive përkatëse. Konkretisht, Plani i Veprimit përcakton objektivat, aktivitetet,

treguesit me bazat dhe objektivat, afatet kohore dhe ndarjen buxhetore për çdo fushë dhe aktivitet për të siguruar angazhimin e duhur financiar dhe të burimeve njerëzore. Rolet dhe përgjegjësitë duhet të përcaktohen qartë për të siguruar përgjegjësitë për zbatimin dhe monitorimin. Koordinimi ndërsektorial është çelësi integral. Një konsensus i gjerë lokal duhet të arrihet përmes një procesi konsultativ.

**Zbatimi i Planit të Veprimit**

Pasi Plani i Veprimit finalizohet dhe miratohet nga Forumi Bashkiak dhe UNICF Shqipëri, faza tjetër është fillimi i zbatimit dhe përmbushja e objektivave të identifikuar në fushat përkatëse, me fokus në përmbushjen e afateve të dakorduara dhe respektimin e buxheteve në dispozicion.

**Monitorimi i progresit dhe gjenerimi i evidencave**

Mblidhen të dhëna vjetore për qëllime monitorimi nga Njësia Koordinuese lokale me mbështetjen e aktorëve të ndryshëm kyç, sipas përgjegjësive të përcaktuara në Planin e Veprimit. Kjo punë do të integrohet sa më shumë që të jetë e mundur në proceset ekzistuese lokale për mbledhjen e të dhënave. Ekzistenca e të dhënave cilësore është gjithashtu e rëndësishme sepse ato mund të ofrojnë shembuj dhe tregime ilustruese se çfarë ka ndryshuar, pse ka ndryshuar dhe çfarë ndikimi ka pasur në të drejtat dhe jetën e fëmijëve. Një analizë e gjetjeve duhet të kryhet çdo vit (nga njësia koordinuese lokale ose partneri i caktuar) për të vlerësuar progresin e bërë drejt objektivave dhe treguesve të rënë dakord në Planin e Veprimit në formën e një raporti..

**Vleresimi**

Bëhet vlerësimi i pavarur i zbatimit të Planit të Veprimit në fund të ciklit për të matur progresin dhe ndikimin e tij në nivel lokal. Vlerësimi do të vlerësojë arritjet e synuara dhe të pasynuara dhe do të hetojë arsyet pse disa aspekte të zbatimit janë zbatuar ose nuk janë zbatuar siç është planifikuar. Autoritetet vendore do të ndajnë gjetjet në publik për të vazhduar nismën dhe komitetet vendore me mbështetjen teknike të njësive koordinuese do të rishikojnë treguesit duke mbajtur treguesit përkatës që ofrojnë dëshmi përkatëse dhe mund të përfshihen tregues të rinj që janë bërë të rëndësishëm. Gjetjet do të shpërndahen në formën e një raporti miqësor për fëmijët dhe adoleshentët.

# OBJEKTIVAT DHE AKTIVITETET

## Qëllimi 1: Çdo fëmijë/adoleshent ka mundësi për të kontribuar në proceset vendim-marrëse që ndikojnë tek ta.

Objektivi 1.1 Fëmijët/adoleshentët shfrytëzojnë platforma efektivepër të ndikuar vendimet që ndikojnë tek ta

**Aktiviteti 1.1.1 Forumi konsultativ i fëmijëve/adoleshentëve (FKF) përcaktohet/rinovohet çdo vit**

**Përshkrimi:** Forumi konsultativ i fëmijëve/adoleshentëve (FKF) pranë bashkisë Dibër, do të shërbejë si një forum diskutativ mes fëmijëve/adoleshentëve, këshillit bashkiak dhe organizmave të tjerë aktivë që janë të angazhuar në hartimin e programeve dhe politikave lokale që ndikojnë tek fëmijët/adoleshentët. Fëmijët përfaqësues nga shkollat 9-vjecare të bashkisë, (sëbashku me një grup përfaqësimi nga grupet vulnerabile) mbidhen në fillim të vitit akademik dhe diskutojnë rreth rëndësisë së përfaqësimit të zërit të tyre në këshillin bashkiak, apo procese të tjera vendimmarrëse në lidhje me nevojat e tyre. Në këtë fazë grupi i fëmijëve zgjedh edhe përfaqësuesit e tyre që do t'i përfaqësojnë në takime të ndryshme gjatë zbatimit të iniciativës. Bashkëpunimi me Zyrën Vendore të Arsimit dhe organizatat e shoqërisë civile lokale është shumë e rëndësisshme për të siguruar që forumi konsultativ është përfaqësues i grupeve në nevojë dhe nevojave të të gjithë fëmijëve në Bashkinë Dibër.

**Afati i Zbatimit**: Viti 2024-2026 **Materialet e zhvilluara**: Marrëveshja e Bashkëpunimit me ZVA, Raportet e aktiviteteve.

---

**Aktiviteti 1.1.2 Takime vjetore të Forumit konsultativ të fëmijëve/adoleshentëve.**

Përshkrimi. Si pjesë edhe e procesit fuqizues të fëmijëve, do të kryhen takime të ndyshme më organizmat kryesorë të bashkisë ku fëmijët diskutojnë dhe marrin iniciativa për të propozuar ndërhyrje dhe projekte që lidhen me nevojat që ata kanë. Do të organizohen takime me këshillin bashkiak pranë të cilit do të prezantojnë disa prioritete që fëmijët kanë në BashkinëDibër; me Kryetarin e Bashkisë; dhe me Komitetin drejtues të iniciatives. Fokusi kryesor i takimeve vjetore do të jetë influencimi i procesit të buxhetimit lokal.

**Afati i Zbatimit**: Viti 2024-2026 **Materialet e zhvilluara:** Raportet e aktiviteteve, minutat e takimeve me Kryetarin e Bashkisë, Këshillin Bashkiak dhe OSHC-të.

---

**Aktiviteti 1.1.3 Organizimi i dy takimeve (vjetore) për të mbledhur opinionet e gjera të fëmijëve (boot camps) për të ndikuar në buxhetin vjetor të bashkisë**

**Përshkrimi:** Nën koordinimin e bashkisë dhe zyrës vendore arsimore, fëmijët pjesë e FKF do të marrin pjesë në dy trajnime gjatë të cilave ata do të aftësohen për të shprehur pikëpamjet dhe opinionet e tyre, të cilat të merren serizosht nga politikbërësit. Fëmijët do të aftësohen për të qënë pjesëmarrës aktiv në procesin e buxhetimit të bashkisë në mënyrë të përshtatshme për moshën, dhe statusin e çështjes së tyre.

**Afati i Zbatimit**: Viti 2024-2026 **Materialet e zhvilluara**: Raportet e trajnimeve, cështjet e ngritura nga fëmijët

**Aktiviteti 1.1.4 Organizimi i aktiviteteve për të promovuar dhe angazhuar adoleshentët (+15vjec) në platformën e U-Reporting**

Arsyeja kryesore për këtë program është t'u ofrojë adoleshentëve mbi moshën 15 vjec një platformë për të shprehur mendimet e tyre në kohë dhe në mënyrë efektive, dhe për të ndikuar në politikat që ndikojnë në jetën dhe të drejtat e tyre. Monitorimi dhe vlerësimi i politikave të qeverisë nga të rinjtë mund të arrihet duke përdorur në mënyrë aktive sondazhin e U-Report. Të dhënat do të kenë rëndësi kur zëri dhe opinionet shpërndahen dhe diskutohen gjerësisht me palët e interesuara, publikun dhe të rinjtë. Për t'u siguruar që U-Report përdoret rregullisht nga adoleshentët dhe të rinjtë dhe zëri/opinioni i tyre ndihmon në formimin e politikave dhe programeve, Bashkia do të bashkëpunojë me Organizata partnere për të zbatuar këtë iniciativë.

**Afati i Zbatimit**: Viti 2024-2026 **Materialet e zhvilluara**: Raportet e trajnimeve, cështjet e ngritura nëpërmjet platformës U-report

**Aktiviteti 1.1.5 Takime vjetore me prindërit (boot camps) për të diskutuar nevojat e tyre dhe të fëmijëve/adoleshentëve të tyre për të ndikuar në buxhetin e bashkisë.**

**Përshkrimi**: Pjesëmarrja e prindërve në proceset vendimmarrëse locale gjithashtu është një nëvojë në rritje në Bashkinë Dibër. Si rrjedhim bashkia në bashkëpunim më organizata të shoqërisë civile do të organizojë disa trajnime vjetore më përindërit dhë fëmijët e tyre për të mbledhur pikëpamjet dhe opinionet e tyre, të cilat ti drejtohen bashkisë dhe këshillit bashkiak. Prindërit në këto aktivitete do të aftësohën që të jenë pjesëmarrës aktiv në procesin e buxhetimit vjetor të bashkisë.

**Afati i Zbatimit**: Viti 2024-2026 **Materialet e zhvilluara**: Raportet e trajnimeve, cështjet e ngritura nga prindërit

Objektivi 1.2 Fëmijët dhe adoleshentet përfitojnë nga politikat vendore të orientuara nga nevojat e tyre

**Aktiviteti 1.2.1 Botimi vjetor i statistikave me fokus fëmijëve dhe adoleshentëve në Bashkinë Dibër**

**Përshkrimi:** Nje botim vjetor do të pregatitet nga Bashkia Dibër, i cili përmban të gjitha statistikat demografike dhe të gjithë ato sektorë që përfaqësojnë interesat e fëmijëve dhe adoleshenteve si: arsimi, mbrojtja sociale, shëndetësia, drejtësia, etj. Këto të dhëna japin një vështrim mbi situatën që ndodhen fëmijët në bashkinë Dibër, dhe i ndihmojnë vendimmarrësit të zhvillojnë plane që kanë në fokus fëmijët. Botimi do të ndihmojë edhe rishikimin e përvitshëm të Planit Bashki Mike e Fëmijëve.

**Afati i Zbatimit**: Viti 2024-2026 **Materialet e zhvilluara**: Botimi, Raportet vjetore të monitorimit

**Aktiviteti 1.2.2 Zhvillimi i Planit Vendor Social që pasqyron nevojat e fëmijëve/adoleshentëve**

**Përshkrimi**: Plani i Kujdesit Social shpreh vullnetin politik dhe moral të bashkisë Dibër për t'u angazhuar në zgjidhjen e problemeve sociale të komunitetit jo vetëm me burime publike vendore por edhe duke ndërtuar partneritete efikase me shoqërinë civile, biznesin dhe partnerët ndërkombëtarë, duke i dhënë një dimension të ri rolit të të gjithë aktorëve në ofrimin e shërbimeve sociale. Me këtë objektiv, iniciativa do të monitorojë zhvillimin e planit social dhe të udhëzojë pasqyrimin e nevojave të fëmijëve.

**Afati i Zbatimit**: Viti 2024 **Materialet e zhvilluara**: Plani Social 2024-2027

---

**Aktiviteti 1.2.3 Monitorimi i zbatimit të Planit lokal social, me fokus pasqyrimin e nevojave të fëmjëve**

**Përshkrimi**: Ky aktivitet nuk mbivendoset me hartimin dhe zbatimin e planit lokal social, i cili përfshin gjerësisht edhe mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna, shfrytëzimi, trafikimi dhe neglizhimi. Gjithsesi, përfshirja e këtij aktiviteti synon të nxisë zbatimin e planit social me fokus fëmijët. Kështu, si pjesë e iniciativës Bashki Mike e Fëmijëve, Shërbimi Social në Bashkinë Dibër do të raportojë mbi zbatimit e planit social çdo vit, duke u fokusuar në përmbushjen e nevojave të fëmijëve/adoleshentëve më të cënueshëm..

**Afati i Zbatimit**: Viti 2024-2026 **Materialet e zhvilluara**: Raportet vjetore të monitorimit

---

**Aktiviteti 1.2.4 Takime periodike ndërsektoriale për të prioritizuar nevojat e fëmijëve/adoleshentëve dhe rritja e bashkepunimit me ZVA**

**Përshkrimi**: Kordinatori i Iniciativës Bashki Mike e Fëmijëve, do të organizojë në vitin e parë takime periodike ndërsektoriale, për të sjellë më në vëmëndjë nëvojat që kanë fëmijët në bashkinë Dibër, gjithashtu për të treguar se si ndërveprimi sektorial mund ti avancoje të drejtat e fëmijëve. Një tjetër objektiv i këtyre takimeve do të jetë rritja e koordinimit dhe bashkëpunimit më organizatat e shoqërisë civile, për të planifikuar dhe zbatur ndërhyrje më efikasë dhe që nuk mbivendosen.

**Afati i Zbatimit**: Viti 2024 **Materialet e zhvilluara**: Raportet vjetore të monitorimit, Minutat e takimeve

---

**Aktiviteti 1.2.5 Organizimi i takimeve gjashtëmujore të Komitetit Drejtues të iniciativës "Bashki Mike e fëmijëve" mbi ecurinë e zbatimit të planit**

**Përshkrimi**: Komiteti drejtues ngrihet në fillim të zbatimit të iniciativës, dhe përben organin drejtues të saj. Roli dhe përgjegjësitë e komitetit janë specifikuar në Termat e Referencës, të detajuara në seksionin 2 të këtij dokumenti. Komiteti mblidhet në fillim për të aproviar Planin e veprimit, dhe në vazhdim të ciklit 3 vjecar mblidhet për të diskutuar rreth statusit të zbatimit të tij. Anëtarët dhe përgjegjësitë e KD janë të detajuara në Seksionin 2 të këtij dokumenti.

**Afati i Zbatimit**: Viti 2024-2026 **Materialet e zhvilluara**: Minutat e takimeve të Komitetit Drejtues

---

**Aktiviteti 1.2.6 Rifreskim vjetor i Planit të aktiviteteve të iniciativës, monitorimi dhe raportimi i zbatimi të tij në Këshillin Bashkiak**

**Përshkrimi:** Bashkia Dibër, nëpërmjet koordinatorit të iniciativës "Bashki mike e fëmijëve" dhe në bashkëpunim me komitetin drejtues, do të udhëheqë rifreskimin vjetor të planit të aktiviteteve bazuar në monitorimin e zbatimit të aktiviteteve në vitin pararendës. Në takimet vjetore me këshillin bashkiak, përfaqësues të bashkisë/komitetit drejtues do të bejnë prezantimin e arritjeve të planit të aktiviteteve dhe gjithashtu do të shtrojnë për aprovim ndyshime apo rifreskime të mundshme.

**Afati i Zbatimit**: Viti 2024-2026 **Materialet e zhvilluara**: Progres raporte vjetore, Plani i aktiviteteve i rifreskuar

---

## Qëllimi 2: Çdo fëmijë/adoleshent respektohet, përfshihet dhe trajtohet në mënyrë të drejtë dhe të barabartë

Objektivi 2.1: Fëmijët/adoleshentët, kryesisht ata nga grupet e cënueshme kanë akses në infrastukturë dhe mbështetje sipas nevojës së tyre

**Aktiviteti 2.1.1 Fëmijët e moshës 0-6 vjeç përfitojnë nga kopshtet dhe çerdhet publike, (përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuar dhe komuniteti Rome/Egjiptian.**

**Përshkrimi**: Fëmijët me aftësi të kufizuar dhe ata nga komunitetet Rome/Egjiptiane kanë të njëjtat të drejta si të gjithë fëmijët. Duke pasur parasysh ofrimin e mundësive për t'u rritur si çdo fëmijë tjetër, ata kanë potencialin për të bërë jetë të përmbushur, dinjitoze dhe për të kontribuar në vitalitetin shoqëror, kulturor dhe ekonomik të komuniteteve të tyre. Duke u bazuar në këtë objektiv, Bashkia Dibër e ka pjesë të punës së saj përfshirjen e të gjithë fëmijëve në sistemin parashkollor (çerdhe dhe kopshte) përfshië ata nga komunitet e cënueshme.

**Afati i Zbatimit**: Viti 2024 - 2026 **Materialet e zhvilluara**: statistikat e fëmijëve pjesë e progres raporteve vjetore të iniciativës.

---

**Aktiviteti 2.1.2 Trajnime për edukatoret e kopshteve rreth edukimit te hershëm holistik**

**Përshkrimi**: Fëmijëria e hershme ofron një dritare kritike të mundësive për të formësuar trajektoren e zhvillimit holistik të një fëmije dhe për të ndërtuar një themel për të ardhmen e tyre. Që fëmijët të arrijnë potencialin e tyre të plotë, siç është e drejta e tyre njerëzore, ata kanë nevojë për kujdes shëndetësor dhe ushqim, mbrojtje nga dëmtimet dhe një ndjenjë sigurie, mundësi për mësim të hershëm dhe kujdes të përgjegjshëm – si të folurit, të kënduarit dhe të luajturit – me prindërit dhe kujdestarët. që i duan ata. Bazuar në këto qasje të reja në edukim, personeli i edukatoreve te kopshtit do të trajnohet në kurrikulën e edukimit të hershëm holitik me mbështetjen e partnerëve vendor dhe ndërkombëtarë.

**Afati i Zbatimit**: Viti 2025 - 2026 **Materialet e zhvilluara**: Raporte të Trajnimeve

---

**Aktiviteti 2.1.3 Ngritja e inventarit GIS (sistemi informacionit gjeografik) të shkollave dhe identifikimi i nevojave për rikonstruksion**

**Përshkrimi:** Bashkia Dibër e ka nevojë në rritje restaurimin apo rindërtimin e shkollave. Bashkia bën monitorime vjetore dhe përpilon nevojat që kanë shkollat për rikonstruksion. Në ndihmë të këtij procesi vendor të rëndësishëm, një bashkëpunim më partnerë ndërkombëtare do të mundësojë inventarizimin në sistemin e inforamacionit gjeografik (GIS) të gjendjes fizike së shkollave përkundjet standardeve të reja të infrastrukturës për institucionet arsimore. Ky inventar do të lejoje analizimin e shpejtë të nevojave dhe prioritizimin e shkollava për rindërtim.

**Afati i Zbatimit:** Viti 2024 **Materialet e zhvilluara:** Inventari GIS i shkollave në Bashkinë Dibër

---

**Aktiviteti 2.1.4 Ngritja e kapaciteteve të profesionistëve për të aplikuar për rekonstruksionin e shkollave në fondin e MAS-it**

**Përshkrimi:** Një vështirësi që haset për të aplikuar ne fondin kombëtar për rehabilitimin e shkollave, është mungesa e kapaciteteve dhe njorurive për të ndejekur proceruat përkatëse. Nëpërmjet bashkëpunimit më partnëre ndërkombëtarë, stafi i bashkisë Dibër do të do të aftësohët për të përmirësuar efektivitetin e praktikave të qeverisjes kur bëhet fjalë për planifikimin dhe aplikimin për grantet e rehabilitimit të shkollave.

**Afati i Zbatimit:** Viti 2024 **Materialet e zhvilluara:** pjesë e progress-raporteve vjetore të iniciativës.

---

**Aktiviteti 2.1.5 Fëmijët dhe të rinjtë përfitojnë nga kabinetet e ICT në shkolla, përfshire komunitetet e cënueshme**

**Përshkrimi:** si pjesë e shkollave të rikonstruktuara do të jenë edhë kabinetet e teknologjisë dhe informacionit (ICT) ky fëmijët do të kenë mundësinë të aftësohën me tej në fushën e inforamacionit si pjesë e aftësive të shëkullit 21. Në bashkëpunim me zyrën vendore arsimore dhe partnerë të tjerë vendore dhe kombëtare bashkia dibër do të mundësojë rritjen e aftësimit në fushën ë teknologjisë dhe inforamcionit.

**Afati i Zbatimit:** Viti 2024 - 2026 **Materialet e zhvilluara:** pjesë e progress-raporteve vjetore të iniciativës.

---

Objektivit 2.2 Prindërit / kujdestarët e fëmijëve kanë akses ndaj programeve të edukimit pozitiv të fëmijëve

**Aktiviteti 2.2.1 Prindërit informohen nëpërmjet aplikacionit Bebbo në lidhje me ushqyerjen dhe rritjen e fëmijëve/adoleshentëve.**

**Përshkrimi:** Të gjithë prindërit dhe kujdestarët, veçanërisht në vitet e para, kanë nevojë për mbështetje për të ditur se nuk janë vetëm në detyrat prindërore, për të përballuar stresin prindëror dhe sfidat e rritjes së një fëmije, për të zgjidhur shqetësimet e tyre dhe për t'i ofruar fëmijës fillimin më të mirë në jetë. Bashkia Dibër, bashkë më partnerët ndërkombëtarë do të punojnë për të rritur ndërgjegjësimin e prindërve për rendësinë e ushqyerjes.

**Afati i Zbatimit**: Viti 2024 – 2026 **Materialet e zhvilluara**: pjesë e progress-raporteve vjetore të iniciativës.

**Aktiviteti 2.2.2 Rritja e ndërgjegjësimit të komuniteteve rreth aftësisë së kufizuar**

**Përshkrimi**: Bashkia Dibër në bashkëpunim me zyrën vendore të arsimit dhe organizata të shoqërisë civile, do të punojnë për të organizuar aktivitete ndërgjegjësuese në lidhje më aftësinë e kufizuar në shkolla, qendrat komunitare dhe qendrat rinore. Rritja e ndërgjegjësimit për aftësinë e kufizuar është e rëndësishme sepse u mëson njerëzve se si ajo ndikon në jetën e tyre dhe si mund të ndihmohet dikush me aftësi të kufizuar. Ndihmon gjithashtu për të ulur stereotipet që lidhen me aftësitë e kufizuara dhe për të hequr stigmën kryesisht rreth paaftësisë mendore. Aktivitetet ndërgjegjësuese në shkolla do të zhvillohen si pjesë e aktiviteteve kurrukulare dhe extra-kurrikulare, ndërsa aktivitetet me komunitetet, prindërit dhe ofruesit e shërbimeve do të mbështeten nga partnerë të ndryshëm.

**Afati i Zbatimit**: Viti 2024 - 2026

**Materialet e zhvilluara**: pjesë e progress-raporteve vjetore të iniciativës.

## Qëllimi 3: Çdo fëmijë jeton në mjedis të sigurtë

Objektivi 3.1 Çdo fëmijë lëvizi i sigurtë dhe i pavarur

**Aktiviteti 3.1.1 Aktivitete edukuese në shkolla për sinjalistikën e sigurtë dhe sigurinë në rrugë**

**Përshkrimi**: Aktivitetet edukuese për sinjalistikën janë pjesë e kurrikuës dhe jepen si orë mësimore, të kombinuara më aktivitete extrakurrikulare, të organizuara nga shkollat. Bashkia në bashkëpunim me ZVA do të monitorojë inforamcionin dhe grupet e fëmijëve të synuar për marrjen e këtij inforamcioni, shoqëruar me punimet në infrastrukturë (korsitë e biçikletave) të cilat kanë përfunduar. Kjo do të forcojë përdorimin e bicikletave më shumë nga fëmijët dhe te rinjtë.

**Afati i Zbatimit**: Viti 2023 - 2025 **Materialet e zhvilluara**: pjesë e progress-raporteve vjetore të iniciativës.

Objektivi 3.2 Çdo fëmijë ndihet i sigurtë në familje dhe komunitet

**Aktiviteti 3.2.1 Fëmijët dhe prindërit informohen rreth rrezikut në internet dhe lundrimit të sigurtë**

**Përshkrimi**: Aktivitetet edukuese për lundrimin në internet janë pjesë e kurrikuës dhe jepen si orë mësimore, të kombinuara më aktivitete extrakurrikulare, të organizuara nga mësuesit e inforamtikës. ASKAP ka zhvilluar gjithashtu manual që të orientojnë rreth mesazheve kryesore që u duhen dhënë fëmijëve. Bashkia në bashkëpunim me organizata partnere do të zgjerojë aktivitetet informuese me prindërit dhe komunitetet.

**Afati i Zbatimit**: Viti 2024 - 2026 **Materialet e zhvilluara**: Raporte të aktiviteteve.

**Aktiviteti 3.2.2 Prindërit përtitojnë nga programe fuqizuese për të parandaluar dhunën dhe trafikimin**

**Përshkrimi**: Nevojat dhe sjelljet e fëmijëve ndryshojnë ndërsa ato rriten dhe të kuptuarit e nevojave të tyre ndihmojnë prinderit dhe profesionistët ti ndihmojnë më shumë ata dhe do të kuptoni këto nevoja. Bashkia Dibër përballet me sfidat e rritjes së dhunës dhe rrezikut për trafikim në komunitetet e cënueshmë, dhe po punon më partnerë që të zhvillojë programe të orientuara ndaj fuqizimit të prindërve, ku prindërit nga komunitetet e cënueshmë të jenë në qendrër të ndërhyrjeve, dhe të ndihmohen në adresimin e këtyre çështjeve.

**Afati i Zbatimit**: Viti 2024 – 2026 **Materialet e zhvilluara**: Progres raporti vjetor

---

**Aktiviteti 3.2.3 Fëmijët dhe prindërit përtitojnë nga programe që parandalojnë martësen e hershme dhe luftojnë normat sociale**

**Përshkrimi**: Si në aktivitetin e mësipërm, Bashkia Dibër po punon më partnerë për të zhvilluar programe për të informuar prindërit rreth rrezikut që kanë normat sociale dhe luftën ndaj matertesave të hershme, ku prindërit nga komunitetet e cënueshmëtë jenë në qendrër të ndërhyrjeve, dhe të ndihmohen në adresimin e këtyre çështjeve

**Afati i Zbatimit**: Viti 2024 - 2026 **Materialet e zhvilluara**: Progres raporti vjetor

---

## Qëllimi 4: Çdo fëmijë ka mundësi të jetojë në mjedis të pastër

Objektivi 4.1 Çdo fëmijë/adoleshent ka akses në ambiente të gjelberta dhe ajër të pastër.

**Aktiviteti 4.1.1 Aktivitete jashtëshkollore organizohen për të promovuar ambjentet e gjelbërta**

**Përshkrimi**: Aktivitetet edukuese për ambjentet e gjebërta janë pjesë e kurrikulës dhe jepen si orë mësimore, të kombinuara më aktivitete extrakurrikulare, të organizuara nga shkollat. Bashkia në bashkëpunim me ZVA do të monitorojë inforamcionin dhe grupet e fëmijëve të synuar për marrjen e këtij inforamcioni.

**Afati i Zbatimit**: Viti 2024 - 2026 **Materialet e zhvilluara**: Progres raporti vjetor

---

**Aktiviteti 4.1.2 Zhvilimi i planit vendor per emergjencat civile**

**Përshkrimi**: Për përmbushjen e detyrave të specifikuara qartë në menaxhimin e risqeve të fatkeqësive dhe mbrojtjen civile, ligji 45/2019 ka sanksionuar për bashkitë detyrime të qarta, siç janë parashikimi i buxhetit vjetor jo më të vogël se 4%, hartimi i vlerësimit të riskut të fatkeqësive, planit vendor të emergjencave civile, strategjisë së zvogëlimit të riskut të fatkeqësive etj. Rritjes së kapaciteteve administrative, teknike dhe financiare të bashkisë për reduktimin e riskut të fatkeqësive dhe mbrojtjen civile do tu kushtohet një rëndësi e veçantë nga Bashkia Dibër.

Qëllimi i Planit të Emergjencave është të përshkruajë strukturën dhe organizimin e nevojshëm për të koordinuar në mënyrë efektive gatishmërinë, përgjigjen dhe rimëkëmbjen ndaj emergjencave nën juridiksionin e bashkisë Dibër.

**Afati i Zbatimit**: Viti 2024 **Materialet e zhvilluara**: Analiza e riskut dhe plani vendor

**Aktiviteti 4.1.3 Aktivitete jashtëshkollore organizohen për të promovuar riciklimin dhe ripërdorimit të mbetjeve urbane**

**Përshkrimi**: Aktivitetet edukuese për mbetjet urbane, riciklimin dh embrojtjen e mjedisit janë pjesë e kurrikulës dhe jepen si orë mësimore, të kombinuara më aktivitete extrakurrikulare, të organizuara nga shkollat. Bashkia në bashkëpunim me ZVA do të monitorojë inforamcionin dhe grupet e fëmijëve të synuar për marrjen e këtij inforamcioni

**Afati i Zbatimit**: Viti 2024 -2026 **Materialet e zhvilluara**: Progres raporti vjetor

**Aktiviteti 4.1.4 Ngritja e parqeve dhe mjediseve miqësore për fëmijët/adoleshentët**

**Përshkrimi**: Bashkia në bashkëpunim me Agjiensitë e Zhvillimit dhe organizata të shoqërisë civile, do të planifikojne dhe zbaotjnë rikonstruksionin e lulishteve dhe parqeve të qytetit. Këto ambjente do të jenë miqësore me fëmijët, ku ata të mundt të argëtohen, kalojnë kohën e lirë dhe të jenë të aksesueshme për të gjithë.

**Afati i Zbatimit**: Viti 2024 **Materialet e zhvilluara**: Progres raporti vjetor

## Qëllimi 5: Çdo fëmijë dhe i ri ka mundësi të shijojë lojën, kohën e lirë dhe të zhvilloje aftësitë për jetën

Objektivi 5.1 Fëmijët/adoleshentët, kryesisht ata nga grupet e cënueshme kanë mundësi për t'u përfshirë në aktivitete në komunitetin e tyre

**Aktiviteti 5.1.1 Qendra Shumsportëshe ofron aktivitete sportive për fëmijët përfshirë ata nga komunitetet e cënueshme**

**Përshkrimi**: Bashkia Dibër e ka një ndër prioritetet kryesore ofrimin e aktiviteteve sportive për fëmijët, adoleshentët dhe të rinjtë e bashkisë. Qendra shumësportëshë, me një traditë të vjetër, vazhdon ofrimin e aktiviteteve, të cilat përfshijë fëmijë nga të gjitha komunitetet, përfshirë ata nga më të cënueshmit. Në bashkëpunim edhe me strukturat e tjera vendore, ky prioritet do vazhdojë të forcohet gjatë viteve të ardhshme dhe të përfshijë fëmijë edhe nga njësitë administrative.

**Afati i Zbatimit**: Viti 2024 -2026 **Materialet e zhvilluara**: Progres raporti vjetor

**Aktiviteti 5.1.2 Ekipet sportive te ngritura nga KOKSH ofron aktivitete sportive për fëmijët përfshirë ata nga komunitetet vulnerabile**

**Përshkrimi**: një tjeter iniciativë që e forcon traditën sportive të bashkisë është edhe bashkepunimi me Komitetin Olimpik Shqipëtar dhe ZVA për të ngritur ekipe sportive ne shkollae e bashkisë. .

**Afati i Zbatimit**: Viti 2024 -2026 **Materialet e zhvilluara**: Progres raporti vjetor

**Aktiviteti 5.1.3 Qendra kulturore e fëmijëve ofron aktivitete sportive/edukuese/argëtuese për fëmijët përfshirë ata nga komunitetet vulnerabile**

**Përshkrimi**: Rivitalizimi i qendres kulturore në Bashkinë Dibër është një tjeter prioritet i bashkisë. Kjo qendër do të ofrojë nje gamë të gjerë aktivitetesh sociale dhe kulturore për fëmijët.

**Afati i Zbatimit**: Viti 2024 -2026 **Materialet e zhvilluara**: Progres raporti vjetor

Objektivi 5.2 Çdo fëmijë ka mundësi të barabarta për aftësim

**Aktiviteti 5.2.1 Zhvillimi i programeve në fushën e ICT për të rritur njohuritë dhe aftësitë në programim dhe përdorimin e teknologjisë**

